



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 477/14prot.,

Datë 26.03.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 429/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 352/2026, datë 05.03.2026, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-67760-11-05-2025, me objekt: “Verifikimi dhe testimi i sistemeve të zjarrit në impiantet përgjatë gazsjellësit TAP”, me fond limit 4.328.529 (kater milion e treqind e njezete e tete mije e peseqind e njezete e nente) lekë pa tvsh (pa TVSH), zhvilluar me datë 30-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Albanian Gas Service Company Sh.a.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri” SHPK me NIPT L62102007V, Adresa: Rruga “Artan Lenja”, Hyrja Nr.1, Zone Kadastrale Nr.8210, Nr.Pasurie 1/301-N3.
- Autoriteti Kontraktor:** Albanian Gas Service Company Sh.a, Adresa: Rruga “Kosovarëve”, pallati: NderPro, Tiranë.
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “FIRE” sh.p.k, me NIPT L71921002H, Adresa: Pallati me shigjeta, Rruga e “Kavajës”, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 05.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 352/2026, ku vendosi:

[...]

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të operatorit ekonomik “Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri” SHPK për procedurën e në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-67760-11-05-2025, me objekt: “Verifikimi dhe testimi i sistemeve të zjarrit në impijantet përgjatë gazsjellësit TAP”, me fond limit 4.328.529 (kater milion e treqind e njezete e tete mije e peseqind e njezete e nente) lekë pa tvsh (pa TVSH), zhvilluar me datë 30-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Albanian Gas Service Company Sh.a.

2. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik “Fire” sh.p.k duke e skualifikuar atë sipas konstatimeve të vendimit të KSHA-së.

3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vëre në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri” SHPK.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2 Me shkresën nr. 47/5 prot., datë 09.03.2026, protokolluar me tonën nr.477/11 prot., datë 11.03.2026, me objekt “ Dërgohet informacion mbi zbatimin e vendimit 352/2026” autoriteti kontraktor Albanian Gas Service Company Sh.a, informon se e ka zbatuar vendimin Nr. 352/2026, datë 05.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik duke bërë rivlerësimin e ofertave si dhe gjithashtu kërkon heqjen e pezullimit në mënyrë që të procedojë.

### II

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

## Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 47/5 prot., datë 09.03.2026, protokolluar me tonën nr.477/11 prot., datë 11.03.2026, me objekt “ Dërgohet informacion mbi zbatimin evendimit 352/2026” autoriteti kontraktor Albanian Gas Service Company Sh.a, informon se e ka zbatuar vendimin Nr. 352/2026, datë 05.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik duke bërë rivlerësimin e ofertave si dhe kërkon heqjen e pezullimit në mënyrë që të procedojë.

II.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor Albanian Gas Service Company Sh.a referuar raportit te, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-67760-11-05-2025, me objekt: “Verifikimi dhe testimi i sistemeve të zjarrit në impjantet përgjatë gazsjellësit TAP”, me fond limit 4.328.529 (kater milion e treqind e njezete e tete mije e peseqind e njezete e nente) lekë pa tvsh (pa TVSH), zhvilluar me datë 30-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Albanian Gas Service Company Sh.a, pasi ka zbatuar vendimin nr. 352/2026 datë 05.03.2026.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-67760-11-05-2025, me objekt: “Verifikimi dhe testimi i sistemeve të zjarrit në impjantet përgjatë gazsjellësit TAP”, me fond limit 4.328.529 (kater milion e treqind e njezete e tete mije e peseqind e njezete e nente) lekë pa tvsh (pa TVSH), zhvilluar me datë 30-01-2026 nga autoriteti kontraktor, Albanian Gas Service Company Sh.a.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar  
Anila Malaj

Anëtar  
Gjergj Mersini

Nënkryetar  
Fiorent Zguro

